

VENDIM
Nr. 68, datë 12.3.2021

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “DRAGOBIA ENERGY” SHPK, PËR RINOVIMIN
E LICENCËS SË FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 10, pikat 1, 2 dhe 3, dhe të nenit 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 35/1 prot., datë 4.3.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k. për rinovim licence në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 403 prot., datë 1.3.2021, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike.

- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, përcaktohet si vijon:

Jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, personi mund/duhet të kërkojë në ERE rinovimin e licencës.

- Referuar sa më sipër, vlefshmëria e licencës nr. 333, seria F16, dhënë shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., me vendimin e ERE-s nr. 19, datë 16.2.2016, rezulton se ka përfunduar në datën 16.2.2021, ndaj afati i fundit për aplikim nga shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. për rinovimin e kësaj licence duhet të ishte data 16.12.2020. Nga sa konstatuar, shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. nuk ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës, pasi aplikimi i saj është paraqitur në ERE në datën 1.3.2021.

- Në nenin 10, pika 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, përcaktohet si vijon:

Çdo aplikim do të paraqitet në përputhje me formën, përmbajtjen, afatet dhe përcaktimet e kësaj rregulloreje, duke plotësuar kërkesat dhe dokumentet e kërkuara në të. Në të kundërt Bordit të ERE-s i propozohet mosfillimi i procedurave të shqyrtimit të aplikimit.

- Shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. nuk ka përcjellë bashkëlidhur kërkesës së saj asnjë dokumentacion dhe nuk ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë, nr. 333, seria F16, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 19, datë 16.2.2016.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti